FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 172

Tiranë – E premte, 26 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 64/2025, datë 24.9.2025	Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit	21883
Vendim i Kuvendit nr. 65/2025, datë 24.9.2025	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit	21884
Vendim i Kuvendit nr. 66/2025, datë 24.9.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 61, datë 16.9.2025, "Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit"	21886
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	21886
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme	21888
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme	21888
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave	21889
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit	21890
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit	21892
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit	21892

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	21893
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.....	21894
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë.....	21896
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes.....	21897
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	21897
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 25.9.2025	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.....	21898

VENDIM
Nr. 64/2025

PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit është si më poshtë:

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat:

1. Admir Kadeli	PS
2. Adi Qose	PS
3. Elton Korreshi	PS
4. Antoneta Dhima	PS
5. Bujar Leskaj	PD
6. Ledina Alolli	PL
7. Igli Cara	PD
8. Besart Xhaferi	PD

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike:

1. Ermal Pacaj	PS
2. Olsi Komici	PS
3. Zegjine Çaushi	PS
4. Erjona Ismaili	PS
5. Aulona Bylykbashi	PS
6. Gent Strazimiri	PD
7. Saimir Korreshi	PD
8. Arian Ndoja	PD
9. Tedi Blushi	PL
10. Tedi Mula	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes:

1. Hysen Buzali	PS
2. Agron Malaj	PS
3. Bujar Rexha	PS
4. Aurora Mara	PS
5. Flamur Noka	PD
6. Isuf Çelaj	PD
7. Fatmir Mediu	Aleanca për Ndryshim
8. Erald Kapri	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet:

1. Ogerta Manastirliu	PS
2. Alma Selami	PS
3. Ana Nako	PS
4. Lindita Nikolla	PS
5. Zamira Sinaj	PS
6. Luan Baçi	PD
7. Kastriot Piroli	PD
8. Brunilda Haxhiu	PL

Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale:

1. Vasil Llajo	PS
2. Brunilda Mersini	PS
3. Ani Dyrmishi	PS
4. Asfloral Haxhiu	PS
5. Hysen Buzali	PS
6. Zija Ismaili	Aleanca për Ndryshim
7. Manjola Luku	PD
8. Mesila Doda	Jashtë grupeve parlamentare
9. Erisa Xhixho	PL

Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm:

1. Klevis Jahaj	PS
2. Ornaldo Rakipi	PS
3. Vullnet Sinaj	PS
4. Besa Spaho	PS
5. Kliti Hoti	PD
6. Fidel Kreka	Aleanca për Ndryshim
7. Klodiana Çapja	PL
8. Redi Muçi	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik:

1. Ramion Kurti	PS
2. Etleva Budini	PS
3. Kiduina Zaka	PS
4. Piro Dhima	PS
5. Arbjan Mazniku	PS
6. Gazment Bardhi	PD
7. Edi Paloka	PD
8. Greta Bardeli	Aleanca për Ndryshim

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural:

1. Agron Gaxho	PS
2. Genti Lakollari	PS
3. Tërmet Peçi	PS
4. Orlando Rakipi	PS
5. Ramadan Likaj	PD
6. Flamur Hoxha	PD
7. Bledion Nallbati	PD
8. Artan Luku	Aleanca për Ndryshim

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën:

1. Xhenis Çela	PS
2. Loer Kume	PS
3. Skënder Pashaj	PS
4. Klodiana Spahiu	PS
5. Ramion Kurti	PS
6. Agron Gjekmarkaj	PD
7. Jozefina Topalli	PD
8. Denisa Vata	Aleanca për Ndryshim
9. Ana Dajko	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme:

1. Sara Mila	PS
2. Ervin Hoxha	PS
3. Romina Kuko	PS
4. Taulant Balla	PS
5. Klodiana Spahiu	PS
6. Tritan Shehu	PD
7. Tomor Alizoti	PD
8. Edmond Haxhinasto	PL
9. Vangjel Dule	Aleanca për Ndryshim
10. Agron Shehaj	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale:

1. Bledi Çomo	PS
2. Erjo Mile	PS
3. Onid Bejleri	PS
4. Erjona Ismaili	PS
5. Belind Këlliçi	PD
6. Elda Hoti	PD
7. Gjin Gjoni	PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 24.9.2025.

VENDIM
Nr. 65/2025

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat janë si më poshtë:

1. Aulona Bylykbashi	PS
2. Ceno Klosi	PS
3. Ermal Pacaj	PS
4. Flamur Hoxha	PD
5. Luan Baçi	PD
6. Edmond Haxhinasto	PL

II. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike janë si më poshtë:

1. Bledi Çomo	PS
2. Xhenis Çela	PS
3. Erjo Mile	PS
4. Greta Bardeli	Aleanca për Ndryshim
5. Gjin Gjoni	PD

III. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes janë si më poshtë:

1. Romina Kuko	PS
2. Arkend Balla	PS
3. Ardit Bido	PS
4. Brunilda Mersini	PS
5. Kastriot Piroli	PD
6. Fidel Kreka	Aleanca për Ndryshim
7. Agron Shehaj	Jashtë grupeve parlamentare

IV. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Edukimin, Shkencën dhe Sportet janë si më poshtë:

1. Etleva Budini	PS
2. Erjo Mile	PS
3. Ledina Alolli	PL
4. Erisa Xhixho	PL

V. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale janë si më poshtë:

1. Olta Xhaçka	PS
2. Ilirjan Pendavinji	PS
3. Loer Kume	PS
4. Klodiana Spahiu	PS
5. Tritan Shehu	PD
6. Kliti Hoti	PD

VI. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm janë si më poshtë:

1. Bora Muzhaqi	PS
2. Hatixhe Konomi	PS
3. Antoneta Dhima	PS
4. Belind Këlliçi	PD
5. Artan Luku	Aleanca për Ndryshim

VII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik janë si më poshtë:

1. Sara Mila	PS
2. Alma Selami	PS
3. Elda Hoti	PD
4. Arian Ndoja	PD

VIII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural janë si më poshtë:

1. Ana Nako	PS
2. Kiduina Zaka	PS
3. Ilirjan Pendavinji	PS
4. Igli Cara	PD
5. Saimir Korreshi	PD

IX. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën janë si më poshtë:

1. Evis Kushi	PS
2. Admir Kadeli	PS
3. Marjana Koçeku	PS
4. Klodiana Çapja	PL
5. Besart Xhaferi	PD

X. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Europën dhe Punët e Jashtme janë si më poshtë:

1. Iris Luarasi	PS
2. Skënder Pashaj	PS
3. Vasil Llajo	PS
4. Mesila Doda	Jashtë grupeve parlamentare
5. Igli Cara	PD
6. Brunilda Haxhiu	PL
7. Erald Kapri	Jashtë grupeve parlamentare

XI. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale janë si më poshtë:

1. Erion Malaj	PS
2. Saimir Hasalla	PS
3. Fatmir Mediu	Aleanca për Ndryshim
4. Gent Strazimiri	PD

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 24.9.2025.

VENDIM
Nr. 66/2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 61, DATË 16.9.2025, "PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 22 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 61/2025, "Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit bëhen këto shtesa:

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat:
Enno Bozdo zëvendëskryetar PD

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike:
Oerd Bylykbashi zëvendëskryetar PD

Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes:
Klevis Balliu zëvendëskryetar PD

Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet:
Luçiano Boçi kryetar PD

Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale:
Bardh Spahia kryetar PD

Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm:
Blendi Himçi zëvendëskryetar PD

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik:
Jorida Tabaku kryetare PD

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural:
Xhelal Mziu zëvendëskryetar PD

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën:
Ina Zhupa kryetare PL

Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme:
Albana Vokshi zëvendëskryetare PD

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.
Ivi Kaso zëvendëskryetar PD

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 24.9.2025.

VENDIM
Nr. 508, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, ujësjellës-kanalizimeve, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në

sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve natyrore, si dhe në sektorin e industrisë minerare.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha:

a) infrastruktura rrugore, hekurudhore, aeroportuale, portuale;

b) transporti rrugor, hekurudhor, ajror, detar;

c) ujësjellës–kanalizimet;

ç) planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban;

d) standardet urbane në ndërtim;

dh) komunikimet elektronike, digjitale dhe postare, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

e) energjia;

ë) eficienca e energjisë;

f) zbutja e efekteve klimatike të ardhura si pasojë e veprimtarisë së fushave të përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

g) hidrokarburet dhe industria hidrokarbure;

gj) minierat, gjeologjia dhe industria minerare.

4. Për përmbushjen e misionit të saj, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndër të tjera:

a) drejton, menaxhon, mbikëqyr e vendos standarde teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve dhe të digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcakton dhe vendos standarde për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizon drejtimin e kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;

b) monitoron realizimin e standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizimeve, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik;

c) harton dhe zbaton monitorimin e trafikut rrugor, detar, ajror e hekurudhor përmes sistemeve inteligjente të vendosura në agjencitë, ndërmarrjet dhe drejtoritë e varësisë për të garantuar sigurinë e çdo sektori të sipërpërmendur, në linjë me parimet ndërkombëtare. Siguron kushte lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operatorëve vendës e të huaj nëpërmjet sistemeve inteligjente, të përshtatshme për t'u përfshirë në sistemet evropiane të informacionit;

ç) harton, zbaton dhe mbikëqyr politikat, strategjitë e standardet në sektorin e energjisë, burimeve energjetike dhe eficiencës së energjisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi të sektorit;

d) harton, zbaton dhe mbikëqyr politikat, strategjitë e standardet në sektorin hidrokarbur dhe industrisë hidrokarbure, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin;

dh) harton, zbaton e mbikëqyr politikat, strategjitë e standardet në sektorin minerar, gjeologjisë dhe industrisë minerare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin.

5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj edhe në këto fusha:

a) Ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:

i. hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara e të shkatërruara;

ii. planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. drejtimin dhe koordinimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, shtetërore e publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;

iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse, në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, për rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019;

b) Kontakton e bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike e donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për secilin prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.

6. Vendimi nr. 111, datë 2.3.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 509, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e politikës së punëve të brendshme në Republikën e Shqipërisë, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike, duke hartuar e duke zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në çështjet e punëve të brendshme.

3. Ministria e Punëve të Brendshme ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore, të:

a) rendit dhe sigurisë publike;

b) luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore;

c) menaxhimit të integruar të kufirit dhe migracionit;

ç) azilit dhe shtetësisë;

d) antiterrorit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

dh) administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi;

e) veprimtarisë së prefektit të qarkut;

ë) shërbimeve të gjendjes civile;

f) hartimit të politikave, koordinimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri;

g) parandalimit, mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe kontrollit/inspektimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.

4. Vendimi nr. 604, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 510, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në raport me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, drejtimi politik i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;

b) realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar, si dhe të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;

c) mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;

ç) bashkërendon veprimtarinë me jashtë të institucioneve qendrore dhe vendore;

d) mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve shqiptarë dhe të drejtat kombëtare të popullsisë shqiptare që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre, në bashkëpunimin me ministritë përgjegjëse;

dh) nxit dhe promovon zhvillimin e komunikimit dhe ndërveprimit të diasporës me shqiptarët jashtë kufijve, për të rritur dhe zhvilluar vlerat dhe traditat më të mira shqiptare;

e) promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;

ë) drejton, bashkërendon dhe shpreh qëndrimet politike në emër të shtetit shqiptar për procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike pranë Bashkimit Evropian dhe në vendet anëtare të tij. Zhvillon dialogun politik, përfshirë lidhur me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë, me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare, në kuadrin e procesit të negociatave të aderimit dhe të procesit të stabilizimit dhe të asociimit;

f) ndjek procedurat për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

4. Vendimi nr. 81, datë 9.2.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 511, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Financave është arritja e stabilitetit ekonomik, nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike.

3. Ministria e Financave e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) politikën makrofiskale;

b) administrimin e të ardhurave;

c) administrimin e buxhetit të shtetit;

ç) menaxhimin e borxhit publik dhe garancive shtetërore të huas;

d) administrimin financiar;

dh) menaxhimin financiar dhe kontrollin;

e) menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;

ë) inspektimin financiar publik;

f) bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;

g) parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit;

gj) lojërat e fatit;

h) aksesin në instrumentet financiare dhe lehtësimin e qasjes në financime për sektorët e nënfinancuar;

i) qasjen në instrumentet e sigurimit dhe risigurimit për risqet që lindin nga fatkeqësitë natyrore.

4. Ministria e Financave, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale e buxhetore, në të cilat përfshihen analizat makrofiskale, parashikimi i të ardhurave, politika e shpenzimeve publike, politika e tatim-taksave, politika e borxhit publik;

b) mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e nismave e të hapave ligjorë, me qëllim administrimin e të ardhurave, në të cilat përfshihen, kryesisht, administrimi i taksave dhe administrimi doganor;

c) hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit, në të cilat përfshihen planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, kontrolli i menaxhimit të investimeve publike, monitorimi i marrëdhënieve financiare ndërqeveritare, kontrolli financiar i transaksioneve publike dhe hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë;

ç) menaxhimin e borxhit publik, në të cilin përfshihen menaxhimi i portofolit të huamarrjes së brendshme e të huaj, menaxhimi i riskut të huamarrjes, si dhe shërbimi i regjistrimit të borxhit;

d) ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar e të kontrollit në të gjitha njësitë e sektorit publik nëpërmjet vendosjes së rregullave, standardeve, procedurave dhe monitorimit të zbatimit të tyre;

dh) miradministrimin financiar të fondeve publike, i cili realizohet nëpërmjet ushtrimit të funksionit të thesarit, zbatimit të metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik dhe kontrollit të brendshëm financiar publik;

e) menaxhimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian, sigurimin e bashkëfinancimit, ndjekjen e zbatimit të kontratave, legjitimitetin dhe rregullsinë e transaksioneve të ekzekutuara brenda sistemit të menaxhimit të decentralizuar, si dhe funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit të kontrollit, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA);

ë) inspektimin financiar publik, si funksion i parashikuar, me qëllim:

i. mbrojtjen e interesave financiarë të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit;

ii. rregullshmërinë e transaksioneve e të veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik;

iii. përcaktimin e shkeljeve të akteve normative, si dhe dyshimeve për mashtrimet e kryera;

iv. zbulimin e parregullsive e të dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike;

v. identifikimin e shkeljeve e të individëve përgjegjës për parregullsitë e zbuluara.

5. Ministria e Financave është institucioni i vetëm që bën bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm nëpërmjet hartimit dhe miratimit të politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve dhe rregulloreve të auditit të brendshëm.

6. Ministria e Financave ka rol të përgjithshëm këshillues në interes të politikave qeveritare për promovimin e efektshmërisë, performancës së lartë dhe mirëqeverisjes financiare në të gjithë sektorin publik dhe në ato institucione financiare në të cilat qeveria merr pjesë.

7. Vendimi nr. 31, datë 17.1.2024, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave", shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 512, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) harton dhe zbaton politikat për turizmin;

b) harton dhe zbaton politikat e qeverisë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale, duke përfshirë ruajtjen dhe promovimin e kulturës së shkruar, nxitjen e krijimtarisë artistike dhe industrive krijuese, zhvillimin e edukimit kulturor, mbrojtjen dhe rijetësimin e vlerave kulturore, si dhe rritjen e dialogut e të shkëmbimit kulturor në kuadër të integrimit evropian dhe ndërkombëtar, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

c) harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse e promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.

ç) harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale.

3. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

3.1 Në fushën e turizmit:

Hartimi dhe zbatimi i politikave për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, të agroturizmit, ekoturizmit, turizmit ujor, zonave bregdetare, ngritjes, monitorimit e kontrollimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit të biznesit në fushën e turizmit, të promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit e bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor, si dhe ushtrimi i funksioneve të tjera, sipas legjislacionit përkatës, nëpërmjet aparatit të ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë.

3.2 Në fushën e kulturës:

a) harton dhe bashkërendon politikat në fushën e artit dhe kulturës, duke përfshirë rijetësimin e trashëgimisë kulturore, nxitjen e investimeve publike e private në këta sektorë, monitorimin e përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, zhvillimin e edukimit kulturor, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, ruajtjen dhe vijimësinë e traditës së harmonisë fetare, si pjesë përbërëse e kulturës shqiptare, si dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kulturës;

b) harton politika mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale dhe jomateriale, duke krijuar një kuadër të përshtatshëm ligjor e mbështetës për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, nxitjen e krijimtarisë artistike në të gjitha fushat, promovimin e arritjeve të kulturës shqiptare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produktit kulturor shqiptar në tregjet ndërkombëtare;

c) harton politika që sigurojnë pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, përmes aderimit dhe përfaqësimit të saj në institucionet përkatëse;

ç) udhëheq, programon, organizon dhe mbështet veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, me synim identifikimin dhe zhvillimin e prirjeve kulturore, artistike e letrare në vend, duke nxitur ndërthurjen e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale e ndërkombëtare, tradicionale e bashkëkohore, si dhe duke krijuar një hapësirë të qëndrueshme dialogu mbarëkombëtar dhe të diversitetit kulturor;

d) realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet publike ose private, persona fizikë apo juridikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike dhe shkencore;

dh) zhvillon politika për mbrojtjen e dijebërjes dhe mbështetjen e artizanatit, si dhe për formimin e vazhdueshëm të personave të licencuar në pasuritë kulturore materiale.

3.3 Në fushën e sportit:

Harton dhe zbaton politikat shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive. Bashkëpunon me organizatat sportive për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

3.4 Në fushën e rinisë harton, zhvillon dhe monitoron politikat, për:

a) mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;

b) krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve;

c) përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e rinisë;

ç) bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë;

d) të rinjtë shqiptarë në diasporë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën;

dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 2.3.2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit", dhe nr. 524, datë 22.9.2021, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët", shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 513, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Mjedisit ka si mision hartimin e zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave.

3. Ministria e Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Sektori i mjedisit, përfshirë politikat, standardet e trajtimit dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, si dhe monitorimin e kontrollin e efekteve, që sjellin në drejtim të ajrit e të mjedisit, cilësinë e ajrit, ndotjen industriale kimikatet, monitorimin e efekteve klimatike, monitorimin e kontrollit të treguesve të mjedisit e të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis;

b) Natyra dhe biodiversiteti, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura;

c) Sektori i pyjeve dhe i kullotave.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 514, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Arsimit harton dhe zbaton politika që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin e sistemit arsimor, respektimin e interesave të individit, të komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe evropiane, sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës për zhvillimin arsimor të fëmijës, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor e të shërbimeve.

Ministria e Arsimit harton dhe zbaton politikat për zhvillimin e kërkimit shkencor, në mbështetje të politikave të zhvillimit të vendit.

Ministria e Arsimit programon, zhvillon e bashkërendon punën për zbatimin e projekteve sportive në shkolla, si dhe hapësirën e nevojshme për zhvillimin e tyre.

Ministria e Arsimit nxit, drejton dhe është përgjegjëse për procesin e botimeve shkollore e kërkimore-shkencore, si dhe të teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës.

3. Ministria e Arsimit ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore, si dhe çdo fushë tjetër përgjegjësie që i ngarkohet, si më poshtë vijon:

a) arsimi parauniversitar;

b) arsimi i lartë;

c) kërkimi shkencor;

ç) botimet për diasporën.

4. Vendimi nr. 523, datë 22.9.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 515, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

b) Zhvillimin dhe monitorimin e politikave të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe me treguesit shëndetësorë të popullatës;

c) Zhvillimin e strategjive e të politikave që synojnë përmirësimin gradual të performancës së të gjithë ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor nëpërmjet sistemit të akreditimit;

ç) Zhvillimin e politikave e të programeve kombëtare që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, si dhe parandalimin, diagnostikimin e trajtimin e sëmundjeve në popullatë;

d) Hartimin dhe përditësimin e të gjitha protokolleve të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore;

dh) Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen sociale, promovimin social, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;

e) Zhvillimin e politikave për çështjet e barazisë gjinore, parandalimin, mbrojtjen dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje ndaj grave dhe grupeve të tjera, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnicitetit dhe minoritetit;

ë) Zhvillimin e politikave për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar, shërbimet shoqërore dhe alternative për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike;

f) Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social, në kuadrin e partneritetit, me qëllim harmonizimin e interesave të palëve për minimizimin e konflikteve sociale;

g) Marrjen e masave dhe ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist;

gj) Sigurimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e duke mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën;

h) Ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për hartimin e strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale, që përfshijnë fushat e përgjegjësisë shtetërore, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Vendimi nr. 609, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 516, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën makro- dhe mikroekonomike, të tregtisë, industrisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim garantimin e një rritjeje ekonomike të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Miradministron burimet, harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin e qytetarin. Promovon dhe orienton drejt risive ndërkombëtare, duke maksimizuar suksesin e investimeve. Komandon instrumente administrative ekzekutive të zgjidhjes së konflikteve shtet-privat;

b) Garanton të drejtën për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë;

c) Mbështet sipërmarrjen private, vendëse dhe të huaj, që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, bashkërendimin e proceseve të

brendshme të institucioneve shtetërore, hartimin e politikave për lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet ndërmjetësimit dhe nismave të integruara qeveritare në këtë fushë;

ç) Synon dhe mundëson stimulimin e aktiviteteve inovative, të cilat do të rrisin produktivitetin ekonomik dhe institucional përmes zhvillimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit efikas;

d) Identifikon koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, kryen studime dhe analiza krahasuese për politikat në nivel rajonal e botëror, për të vlerësuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave qeveritare, me qëllim hartimin e strategjive që mundësojnë zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

dh) Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, bashkërendon dhe zbaton politikat shtetërore që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, të ofruara për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e jetesës, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike, sigurimin e cilësisë dhe përballimin e tyre;

e) Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, bashkërendon dhe zbaton politikat shtetërore për rregullimin dhe harmonizimin e planeve dhe projekteve të digjitalizimit, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike sipas praktikave të Bashkimit Evropian;

ë) Zhvillon politikën shtetërore në fushën e mbështetjes së *startup*-eve dhe të mbështetjes së veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë;

f) Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse harton, bashkërendon, mbështet dhe zbaton politikat shtetërore për kërkimin shkencor në funksion të zhvillimit ekonomik dhe nëpërmjet zonave të lira ekonomike e parqeve teknologjike.

3. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

3.1 Lidhur me fushën e ekonomisë:

a) strehimin;

b) punësimin;

c) sigurimet shoqërore;

ç) arsimin dhe formimin profesional;

d) marrëveshjet e tregtisë së lirë;

dh) nxitjen e investimeve;

e) nxitjen e sektorit të industrisë joushqimore;

ë) administrimin e pronës shtetërore;

f) mbështetjen e partneritetit publik privat;

g) regjistrimin dhe licencimin e operatorëve ekonomikë;

gj) shërbimin e akreditimit dhe standardizimit;

h) mirëmbajtjen, kalibrimin dhe inspektimin e mjeteve matëse;

i) pronësinë industriale;

j) mbrojtjen e konsumatorëve;

k) zonat ekonomike dhe teknologjike;

l) ndihmën shtetërore dhe garancitë shtetërore;

ll) garantimin e bashkëpunimit institucional mbi zhvillimin e politikave ekonomike të dialogut dhe këshillimit ndërmjet organeve të administratës shtetërore, partnerëve socialë dhe sektorit privat, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat dhe të partnerëve socialë në këtë proces;

m) zhvillimin e politikave në favor të sipërmarrjes dhe biznesit, në përputhje me politikën evropiane në bashkëpunim me dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe shoqërinë civile;

n) krijimin e një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen dhe biznesin, me qëllim nxitjen e biznesit dhe liberalizimin e tregut, nëpërmjet identifikimit të pengesave në sektorët e ekonomisë dhe formulimit të strategjive të ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative dhe kostove të biznesit.

3.2 Lidhur me fushën e inovacionit:

a) synon dhe mundëson stimulimin e aktiviteteve inovative, të cilat do të rrisin produktivitetin ekonomik dhe institucional përmes zhvillimit të teknologjisë informative dhe bashkëpunimit efikas;

b) identifikon koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, kryen studime dhe analiza krahasuese për politikat në nivel rajonal e botëror për të analizuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave qeveritare, me qëllim zhvillimin dhe hartimin e analizave strategjike, që mundësojnë zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

c) orienton:

i. promovimin e inovacionit dhe të teknologjisë informative në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit;

ii. zhvillimin e bashkëpunimit përmes programeve të trajnimit/konsulencës;

iii. konsolidimin e fondit për shërbimet inovative për përkrahje të sektorëve zhvillimorë të ekonomisë;

iv. krijimin e mekanizmave institucionalë koordinues ndërmjet shkencës, sektorit privat dhe politikëbërjes.

ç) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikat shtetërore dhe strategjitë, për:

i. sigurimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike;

ii. rritjen e cilësisë së shërbimeve në çdo sektor publik;

iii. lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike;

iv. rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të garantuar aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike.

d) synon mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

dh) synon krijimin dhe zhvillimin e *startup*-eve;

e) synon mbështetjen e veprimtarisë së punonjësve lëvizës digjitalë.

4. Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit ka një rol të përgjithshëm këshillues dhe koordinues në interes të politikave qeveritare për efektshmërinë, performancën e lartë dhe mirëqeverisjen në të gjithë sektorin publik dhe institucionet qeveritare, në kuadër të zhvillimit të sipërmarrjes dhe klimës së biznesit.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.1.2024, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit", dhe nr. 558, datë 4.10.2023, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit", shfuqizohen.

6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 517, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje e në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë dhe të legjislacionit në fuqi.

3. Fushat e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë dhe kompetencat për realizimin e tyre parashikohen në nenet 5 dhe 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar.

4. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.

5. Vendimi nr. 606, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 518, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është hartimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e politikave të mbrojtjes kombëtare duke siguruar pavarësinë e vendit, si dhe mbrojtja e tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues.

3. Në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes përfshihen:

a) mbrojtja dhe siguria kombëtare;

b) zhvillimi strategjik i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

c) arsimi ushtarak;

ç) mjekësia ushtarake:

d) industria ushtarake;

dh) inovacioni në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

e) emergjencat civile;

ë) rezervat materiale të shtetit;

f) çdo fushë tjetër që i përcaktohet me ligj apo akt nënligjor.

4. Ministria e Mbrojtjes për realizimin e fushës së përgjegjësisë, sipas pikës 3, të këtij vendimi, është përgjegjëse, për:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

b) zhvillimin e kapaciteteve operacionale, njerëzore dhe infrastrukturore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet modernizimit të tyre të vazhdueshëm;

c) hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të industrisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë;

ç) miradministrimin dhe zhvillimin e pronave të paluajtshme të mbrojtjes, me qëllim maksimizimin e funksionalitetit në shërbim të Forcave të Armatosura, si dhe rritjes së eficiencës së tyre ekonomike;

d) përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes e të sigurisë dhe bashkëpunimit me NATO-n;

dh) hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e mbrojtjes civile;

e) hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave për krijimin dhe menaxhimin e rezervave ushtarake e të rezervave materiale të shtetit;

ë) nxitjen e inovacionit dhe të proceseve të lidhura me teknologjinë dhe projektet që i përkasin fushës së mbrojtjes dhe sigurisë, dhe kontrollit të territorit.

5. Vendimi nr. 605, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes", shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 519, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe

sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutore.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) harton e zbaton politikat shtetërore për çështjet e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutore;

b) harton e propozon miratimin e projektakteve për përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, veterinarisë, peshkimit dhe akuakulturës me normat e kërkesat e Bashkimit Evropian, miraton projektaktet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë, si dhe vlerëson nevojat e planifikon fondet e nevojshme për zbatimin e tyre;

c) harton e zbaton politikat orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë;

ç) ndjek përgatitjen e strukturave të saj për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të Komisionit Evropian për zhvillimin rural, harton e zbaton programin IPARD, në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian;

d) zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët, agrobizneset dhe peshkatarët, bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre;

dh) harton e zbaton politika për miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë;

e) harton e zbaton politika për menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet;

ë) harton e zbaton politikat për ushqimin, sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;

f) harton e zbaton politikat në fushën e veterinarisë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, epidemiologjinë, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe lëvizjeve të tyre, me qëllim garantimin e shëndetit publik veterinar;

g) harton e zbaton politikat në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe luftimit të dëmtuesve;

gj) bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe të kullotave;

h) harton e zbaton politikat shtetërore për peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri dhe menaxhimin e burimeve peshkore;

i) harton e zbaton politikat e zhvillimit rural, agroturizmit, për standardet e cilësisë, produktet organike, si dhe cilësinë e jetës në fshat dhe zhvillimin rural;

j) kujdeset për ngritjen e funksionimin e shërbimit këshillimor publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, si dhe nxit shërbimet digjitale dhe inovacionin në bujqësi, duke bashkëpunuar me universitetet bujqësore;

k) harton e zbaton politikat për marketingun agrar dhe agropërpunues. Përgatit strategji dhe projekte, duke bashkëpunuar edhe me organizma ndërkombëtarë për analizimin e zhvillimin e shkëmbimeve tregtare dhe sidomos për rritjen e eksportit të produkteve shqiptare;

l) harton regjistrin e fermerëve.

4. Vendimi nr. 608, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 520, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore, të lidhura me veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

3. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në kuadër të fushës së përgjegjësisë së tij, ushtron këto kompetenca:

a) Ndjek hartimin dhe realizimin e zbatimit të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit e të vetëqeverisjes vendore;

b) Bashkërendon punën për propozimin, përmirësimin dhe hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore në fushën e decentralizimit e të vetëqeverisjes vendore, si dhe jep mendim për projektaktet që kanë të bëjnë me çështje të lidhura me njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) Mbikëqyr punën për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Vetëqeverisjen Vendore, si dhe planit të veprimit përkatës;

ç) Përfaqëson politikat e qeverisë në fushën e vetëqeverisjes vendore dhe koordinon punën me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë, që mbështesin zhvillimin e njësive të vetëqeverisjes vendore;

d) Drejton dhe bashkërendon punën ndërmjet strukturave të ngritura në kuadrin e marrëdhënieve ndërinstitucionale me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë;

dh) Kujdeset për përmbushjen e detyrimeve, si dhe monitoron e koordinon masat, që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, për sa ato kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore;

e) Siguron krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim monitorimin dhe zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

ë) Bashkërendon dhe mbështet punën e organeve përgjegjëse në funksion të zbatimit të politikave shtetërore në fushën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, në përputhje me legjislacionin përkatës;

f) Kryen edhe funksione e veprimtari të tjera brenda fushës së përgjegjësisë, që i ngarkohen në përputhje me ligjin, marrëveshjet ndërkombëtare, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhrat e Kryeministrit, apo që nuk i janë ngarkuar specifikisht një organi apo institucioni tjetër shtetëror, por kanë të bëjnë me vetëqeverisjen vendore.

4. Vendimi nr. 557, datë 4.10.2023, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor", shfuqizohet.

5. Ngarkohet ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/09/26 13:49:53 +02'00'
11a9307c29174640ab0f082d7dd0d9d4202509261
3494580031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)